**TABELË E FUNKSIONEVE, DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TË DREJTORËVE/IVE, ARSIMIT, KUALIFIKIMET E DREJTUESVE**

| **Këshilli Drejtues Drejtoria/Struktura** | **Funksionet:** | **Arsimi dhe kualifikimet e drejtorëvë** |
|---|---|---|
| **KËSHILLI DREJTUES** | KD është organi më i lartë drejtues i AKEP-it i zgjedhur nga Kuvendi sipas ligjit nr. 9918,i ndryshuar, i cili ushtron veprimtarinë e tij vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale dhe të pavarur sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>Funksioni i Këshillit Drejtues është drejtimi kolegjial nëpërmjet vendimmarrjes i veprimtarisë së AKEP-it për përmbushjen e përgjegjësive, detyrave dhe funksioneve të tij, të përcaktuara në ligjin nr. 9918 dhe ligjin nr.46/2015.<br><br>KD, ushtron funksionet me anë të vendimmarrjes në mbledhjet e tij, të cilat organizohen dhe mbahen në përputhje me ligjin nr. 8480. | http://akep.al/akep-sq/keshilli-drejtues<br><br>*Z. Ilir Zela*<br><br>*Z.Alban Karapici*<br><br>*Znj. Anila Denaj*<br><br>*Znj. Ketrin Topciu*<br><br>*Znj.Klarina Allushi* |
| **KABINETI KRYETARIT**<br><br>Drejtor Kabineti<br>Këshilltar | Për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave Kryetari ndihmohet nga funksionarët ndihmës në përbërje të Kabinetit sipas ligjit nr. 9584.<br><br>Ndihmon titullarin e institucionit për kryerjen e detyrave drejtuese ekzekutive të institucionit dhe zhvillimin e mbledhjeve të organit kolegjial. | **Drejtori i Kabinetit**<br><br>*Z. Rudolf Papa*<br><br>**Këshilltari**<br><br>*Z. Altin Rrapaj* |

| | | |
|---|---|---|
| **DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK DHE STATISTIKAVE**<br><br>Drejtor<br>Përgjegjës Sektori<br>Specialistë<br><br>*Sektori i Analizës së Tregjeve dhe Masave Rregullatore*<br><br>*Sektori i Statistikave dhe Shërbimit Universal* | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë se Rregullimit Ekonomik dhe e Statistikave eshte kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave të AKEP-it të parashikuara në legjislacionin e fushës për rregullimin e konkurrencës dhe sigurimin e shërbimit universal në tregun e komunikimeve elektronike me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatoretë përcaktuara në Ligjin 9918. | **Drejtor**<br><br>*Z.Pajtim Melani* |
| **DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË BURIMEVE TË FUNDME, AUTORIZIMEVE DHE FACILITETEVE**<br><br>Drejtor<br>Përgjegjës Sektori<br>Specialistë<br><br>*Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të Frekuencave dhe Numeracionit*<br><br>*Sektori i Autorizimeve dhe Faciliteteve.* | Objekti i veprimtarisë së Drejtorise se Administrimit të Burimeve të Fundme Autorizimeve dhe Faciliteteveështë kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave ligjore të AKEP-it për administrimin, përpunimin, dhe analizimi i informacionit në fushën e koordinimit dhe administrimit të frekuencave, numeracionit, autorizimeve dhe faciliteteve. | **Drejtor**<br><br>*Z.Shefqet Meda* |

| | | |
|---|---|---|
| **DREJTOR I SHËRBIMEVE POSTARE DHE INTEGRIMIT**<br><br>Drejtor<br>Përgjegjës Sektori<br>Specialistë<br><br>*Sektori i Shërbimeve Postare*<br>*Sektori i Integrimit* | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Postare dhe Integrimit është përmbushja e objektivave të përcaktuar në ligjin 46/2015, rregullimin e aspekteve ekonomik të tregut postar, sigurimin e konkurrencës së ndershme dhe efektive sidomos në kushtet e liberalizimit të mëtejshëm të tregut postar, garantimin e përfitimeve maksimale për konsumatorët. Lidhur me çështjet e integrimit, Drejtoria e Shërbimeve Postare dhe Integrimit, ka për objekt të punës zbatimin e politikave strategjike kombëtare për integrimin europian sipas legjislacionit në të cilën përfshihet veprimtaria e AKEP, si dhe ndjekjen e marrëdhënieve me publikun dhe jashtë. | **Drejtor**<br><br>*Z. Bleron Dokle* |
| **DREJTORIA MONITORIMIT FREKUENCAVE, CILËSISË DHE INSPEKTIMIT**<br><br>Drejtor<br>Përgjegjës Sektori<br>Specialistë<br>Inspektor<br><br>*Sektori i Administrimit të Qëndres Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave*<br><br>*Sektori i Planifikimit dhe Koordinimit të Monitorimit dhe Inspektimit*<br><br>*Sektorët Rajonal të Monitorimit dhe Inspektimit në Krujë, Shkodër, Vlorë, Korçë* | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit (DMFCI) është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave ligjore të AKEP-it për monitorimin e spektrit të frekuencave, zbatueshmërinë e standardeve dhe cilësisë të rrjeteve dhe ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, si dhe inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë të shërbimit postar. | **Drejtor** |

| | | |
|---|---|---|
| **DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE ZHVILLIMIT TË BROADBAND**<br><br>Drejtor<br>Specialistë<br><br>*<u>Zyra e Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimit Broadband</u>*<br><br>*<u>Zyra e administrimit të Domain.AL</u>* | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe e Zhvillimit të Broadband është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave ligjore të AKEP-it për shërbimet me brez të gjerë, aksesin në internet, administrimin e Domain.al, si dhe mbështetja teknike për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të brendshëm dhe aplikacioneve që përdoren për ofrimin e shërbimeve ndaj sipërmarrësve dhe të tretëve. | **Drejtor** |
| **DREJTORIA E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT**<br><br>Drejtor<br>Specialistë<br><br>*<u>Zyra e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve</u>*<br><br>*<u>Zyra e Mbrojtjes së Konsumatorit</u>* | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është kryerja e detyrave për sigurimin e mbështetjes në aspektin ligjor të veprimtarisë së AKEP–it gjatë ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve rregullatore dhe administrative, si dhe mbrojtjes së përdoruesve. | **Drejtor** |

| | | |
|---|---|---|
| **DREJTORIA E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE PAGESAVE**<br><br>Drejtor<br>Përgjegjës Sektori<br>Specialistë<br><br>*Sektori i Menaxhimit Financiar*<br><br>*Sektori i Pagesave* | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Pagesave është kryerja e detyrave për sigurimin e mbështetjes në aspektin financiar të veprimtarisë së AKEP–it gjatë ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve rregullatore, si dhe menaxhimit dhe administrimit financiar të institucionit. | **Drejtor**<br><br>*Znj. Enkeleda Pojani* |
| **DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRIMIT TË BRENDSHËM**<br><br>Drejtor<br>Specialistë<br>Punonjës Informacioni/Magazinier<br>Shoferë<br>Pastrues<br><br>*Sektori i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe arkiv/protokollit.*<br><br>*Sektori i shërbimeve mbështetëse.* | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe e Administrimit të Brendshëm është sigurimi i organizimit, drejtimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, shërbimeve mbështetëse sipas legjislacionit në fuqi me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore dhe administrimin sa më profesional dhe eficent të kapaciteve njerëzore. | **Drejtor**<br><br>*Znj.Milena Ismaili* |

| | | |
|---|---|---|
| Lista e numrave të telefonit dhe e-mailet institucionale. | Rruga “Reshit Çollaku", Tiranë<br>Tel : 0035542259571<br>Fax : 0035542259106<br>e-mail :info@akep.al<br><br>**Përgjegjës për marrëdhëniet me publikun**<br>pr@akep.al<br>Tel: 0035542250572<br><br>**Përgjegjes për Autorizim të Përgjithshëm**<br>autorizime@akep.al<br>Tel : 0035542250928<br><br>**Përgjegjës për Sektorin Postar**<br>posta@akep.al<br>Tel : 0035542259572<br><br>**Përgjegjës për Rregullimin e Tregut dhe Konsumatorin**<br>tregu@akep.al<br>konsumatori@akep.al<br>Tel : 0035542259572<br><br>**Përgjegjës për Administrimin e Frekuencave**<br>frekuenca@akep.al<br>Tel : 0035542250928<br><br>**Përgjegjës për Numeracionin dhe Miratim Tipi**<br>numeracioni@akep.al,konformiteti@akep.al<br>Tel : 0035542250928<br><br>**Përgjegjës për Rregjistrim Domain**<br>domain@akep.al<br>Tel : 0035542250926<br><br>**Përgjëgjes për Çështjet Financiare**<br>financa@akep.al<br>Tel : 0035542250927<br><br>**Përgjegjës për Aplikim Sistem PMR**<br>Frekuenca@akep.al<br>Tel : 0035542250928<br><br>**Koordinatori për të Drejten e Informimit**<br>koordinator.informimi@akep.al<br>Nr. tel : +355 42 250 572<br>Orari Zyrtar : 08.00 - 16.30 | http://akep.al/kontakte |